



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 284, Datë 07.11.2022

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 150, DATË
10.06.2022 “MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “DANSKE
COMMODITIES ALBANIA” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 07.11.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1885 prot, datë 01.11.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s n. 150, datë 10.06.2022 “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “DANSKE COMMODITIES ALBANIA” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike” dhe qëndrimin e Këshilltares së Bordit,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 150, datë 10.06.2022 ka vendosur:
 - Të rinovojë licencën e shoqërisë “Danske Commodities Albania” sh.p.k., me nr. 374 Seria T12/T17 në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 94, datë 04.07.2017, për një afat 5 (pesë) vjeçar, duke filluar nga data 04.07.2022.
 - Shoqëria “Danske Commodities Albania” sh.p.k. në përfundim të procesit të vlerësimit nga organi tatimor, të paraqesë në ERE, vërtetimin e detyrimeve tatimore të pastër.
 - Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të vendimmarrjes së organit tatimor në përfundim të procesit të vlerësimit mbi procesin e apelimit të nisur nga shoqëria “Danske Commodities Albania” sh.p.k., që mund të ndryshojë rrethanat e kësaj vendimmarrjeje.
- ERE njoftoi shoqërinë për këtë vendimmarrje me shkresën nr. 477/4 prot., datë 17.06.2022.

- Me dokumentacionin e depozituar me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 477/5 prot., datë 17.10.2022, shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 2 dhe 3 të vendimit nr. 150/2022.
- Në nenin 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të shfuqizojë pikën 2 dhe pikën 3 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 150, datë 10.06.2022 “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “DANSKE COMMODITIES ALBANIA” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI